# FLETORJA ZYRTARE

# E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

| **Nr. 36** | **2002** | **Korrik** |
|---|---|---|


PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr. 297, datë 27.6.2002 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për rritjen e pagave të punonjësve të institucioneve buxhetore me ndryshimet përkatëse……………………………………………………… ……. | 1087 |
| Vendim i KM nr. 298, datë 27.6.2002 | Për disa ndryshime në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar", me ndryshimet përkatëse………………………………………. | 1093 |
| Vendim i KM nr. 299, datë 27.6.2002 | Për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve …… | 1096 |
| Vendim i KM nr. 300, datë 27.6.2002 | Për disa ndryshime në vendimin nr.437, datë 3.9.1993 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të tatimeve", me ndryshimet përkatëse ………………………… | 1097 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr. 305, datë 27.6.2002 | Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të INSTAT-it …………………………………… | 1098 |
| Vendim i KM nr. 306, datë 27.6.2002 | Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin Ministrisë së Shëndetësisë ………………………………………………….. | 1099 |
| Vendim i KM nr. 307, datë 27.6.2002 | Për rritjen e pagës minimale në shkallë vendi …………… | 1107 |
| Vendim i KM nr. 308, datë 27.6.2002 | Për rritjen e nivelit të pagesës së papunësisë ………………. | 1108 |
| Vendim i KM nr. 309, datë 27.6.2002 | Për disa ndryshime në vendimin nr.429, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të Policisë Gjyqësore" ……………………………………………………. | 1108 |
| Vendim i KM nr. 310, datë 27.6.2002 | Për disa ndryshime në vendimin nr.185, datë 16.4.1993 të Këshillit të Ministrave "Për pagat dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve të shërbimit pyjor", me ndryshimet përkatëse | 1109 |
| Vendim i KM nr. 311, datë 27.6.2002 | Për disa ndryshime në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave "Për strukturën dhe pagat e punonjësve të Policisë së Ndërtimit", me ndryshimet përkatëse ……………………………………………………… | 1110 |
| Vendim i KM nr. 325, datë 27.6.2002 | Për disa ndryshime në vendimin nr.60, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve”, me ndryshimet përkatëse, në vendimin nr.54, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik dhe ushtarakëve të Ministrisë së Drejtësisë” dhe në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve në shërbimin informativ shtetëror”……………………………… | 1111 |
| Vendim i KM nr. 326, datë 27.6.2002 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 358, datë 28.7.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve të doganave”, me ndryshimet përkatëse ……………………………………………………… | 1112 |
| Vendim i KM | Për disa ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të | 1114 |

| | |
|---|---|
| nr. 327, datë 27.6.2002 | Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", me ndryshimet përkatëse……… |

# V E N D I M
## Nr. 297, datë 27.6.2002

## PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RRITJEN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

i)

I. Në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, lidhja nr. 2 "Klasifikimi i pagave të punonjësve të administratës së lartë shtetërore, institucioneve qendrore dhe funksionarëve në pushtetin vendor" zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në pikën 2 të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Lidhja II "Paga bazë sipas klasave", lidhja II/1 "Paga bazë sipas klasave për punonjësit e shëndetësisë" dhe lidhja II/M "Paga bazë sipas klasave për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar" zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Shtohen lidhja II-29 "Niveli i pagës për punonjësit e Galerisë Kombëtare të Arteve, të Muzeut Historik Kombëtar, të Muzeut të Artit Mesjetar, Korçë; të Muzeut Onufri, Berat, dhe të Muzeut Gjergj Kastriot Skënderbeu, Krujë", lidhja II-30 "Niveli i pagës për punonjësit e administratës së Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë" dhe lidhja II-31 "Niveli i pagës për punonjësit e Gjykatës së Lartë".

Lidhja II-11 "Niveli i pagës për drejtuesit e institucioneve në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme në RTV" dhe lidhja II-20 "Niveli i pagës për punonjësit e Komitetit të Zhvillimit të Turizmit"" shfuqizohen.

3. Në pikën 12 paga bëhet 310 lekë.

4. Në pikën 13 shpërblimi për çdo orë mësimore bëhet 180 lekë.

5. Në pikën 17 paga për çdo orë mësimore bëhet si më poshtë vijon:

- në shkollat e larta310 lekë
- në shkollat e mesme180 lekë
- në shkollat 8-vjeçare150 lekë

6. Në pikën 19 paga mujore për emërtimet e mëposhtme bëhet:

Akademik66 300 lekë

Profesor; Drejtues kërkimesh63 500 lekë

Profesor i asociuar; Mjeshtër kërkimesh53 600 lekë

Pedagog me gradë shkencore36 700 lekë

Shpërblimi mujor bëhet:

Profesor; Drejtues kërkimesh5 600 lekë

Profesor i asociuar; Mjeshtër kërkimesh4 900 lekë

Për gradën shkencore "Doktor i shkencave"4 200 lekë

7. Në pikën 20, në fund të paragrafit të parë shtohet një fjali me këtë përmbajtje: "Përjashtohen nga kjo shtesë nëpunësit civilë të aparatit të secilës ministri, të cilët trajtohen në pagë sipas vendimit nr. 711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore""."

8. Në pikën 23, në paragrafin e fundit, duke filluar nga data 1 janar 2002, fjala "…bazë…" shfuqizohet.

9. Në pikën 24, paragrafët i dytë, i tretë dhe ai i katërt zëvendësohen me paragrafët me këtë

përmbajtje:

"Për projektet me rëndësi të veçantë, drejtori i projektit barazohet në pagë nëpunësin civil të kategorisë I-b, të vendimit nr. 711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore"". Rëndësia e projektit caktohet nga Kryeministri.

Për projektet e tjera, drejtori barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a, të vendimit nr. 711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave.

Në të dyja rastet, punonjësit e tjerë barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-b, të vendimit nr. 711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave.".

10. Në lidhjen II-a, kreu II "Shtesa të tjera" të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- Pika 6 riformulohet me këtë përmbajtje:

"6. Inspektorëve në agjencitë rajonale të mjedisit10 për qind".

- Në pikën 16, në fund të paragrafit të dytë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Shtesat e mësipërme i përfitojnë shoferët, që janë në dispozicion të funksionarëve, sipas përcaktimit në strukturat organike, të miratuara për çdo institucion.".

Në pikën 22 fjalët "…të cilët paguhen me lidhjen II-M…" shfuqizohen.

Shtohet pika 27, me këtë përmbajtje:

"27. Punonjësit, të cilët trajtohen në pagë sipas vendimit nr. 711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave nuk përfitojnë nga shtesat që përcaktohen në pikat 1, 3, 4, 5, 9, 10, 13, 19 dhe 20 të kësaj lidhjeje.".

Në lidhjen I "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit" bëhen këto ndryshime:

Në klasifikimin "A6" emërtimet "Kryetar i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit" dhe "Kryetar i Komisionit të Shërbimit Civil" shfuqizohen.

Në klasifikimin "A8" emërtimi "Anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil" shfuqizohet.

Në klasifikimin "A 11" bëhen këto shtesa:

Shtohet emërtimi "Këshilltar i Kryetarit të Gjykatës së Lartë".

Shtohet emërtimi "Grupi i parë i drejtorëve të drejtorive të përgjithshme dhe i drejtuesve të institucioneve qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave".

Në lidhjen II-4/1 "Drejtori të përgjithshme dhe institucioneve qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave", shfuqizohen emërtimet në kreun "Grupi I" dhe bëhen reflektimet në lidhjet përkatëse të secilit institucion.

Në klasifikimin "A12" shtohet emërtimi "Drejtor i drejtorive të përgjithshme, në varësi të ministrive" dhe shfuqizohet lidhja II-5/1 "Drejtori të përgjthshme, në varësi të ministrive". Reflektimi i tyre bëhet në lidhjen II-5.

Shfuqizohen emërtimet e mëposhtme:

"Drejtor i Përgjithshëm i RTV-së";

"Zëvendëskryetar i Komitetit të Zhvilimit dhe Turizmit";

"Kryetar i Agjencisë Kombëtre të Mjedisit".

Në klasifikimin "B1" emërtimi "Kryetar i këshillit të rrethit" bëhet "Kryetar i këshillit të qarkut" dhe emërtimi "Grupi i parë i drejtorëve (departamenteve) në varësi të Presidencës, Këshillit të Ministrave, Kuvendit" shfuqizohet.

Në klasifikimin "B2" emërtimi "Drejtor i drejtorisë së përgjithshme në ministri dhe në varësi të ministrive" shfuqizohet.

Në klasifikimin "B3" bëhen këto ndryshime:

1. Shtohen emërtimet e mëposhtme:

"Drejtor i Zyrës së Administrimit të Qytetit Antik të Butrintit";

Drejtor i Institutit të Monumenteve të Kulturës;

Drejtor i Bibliotekës Kombëtare;

Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar;

Drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve;

Drejtor i Teatrit të Operas dhe Baletit;

Drejtor i Teatrit Kombëtar;

Zëvendësdrejtor në drejtoritë e përgjithshme, në varësi të ministrive;

Zëvendësdrejtor i grupit të parë të drejtorive të përgjithshme dhe zëvendësdrejtues të institucioneve qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave.”.

2. Shfuqizohen emërtimet e mëposhtme:

“Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i RTV-së;

Drejtor i Radios së Jashtme;

Drejtor i Radios së Brendshme;

Drejtor i Televizionit.”.

- Në klasifikimin “B4” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Emërtimi “Zëvendëskryetar i këshillit të rrethit” bëhet “Zëvendëskryetar i këshillit të qarkut”.

2. Shtohen emërtimet e mëposhtme:

“Përgjegjës sektori në Gjykatën e Lartë;

Drejtor i Muzeut Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, Krujë;

Drejtor i Muzeut të Artit Mesjetar, Korçë;

Drejtor i Muzeut Onufri, Berat.”.

3. Shfuqizohen emërtimet e mëposhtme:

“Drejtor i Institutit të Monumenteve të Kulturës;

Drejtor i Bibliotekës Kombëtare;

Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar;

Drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve;

Drejtor i Teatrit të Operas dhe Baletit;

Drejtor i Teatrit Kombëtar;

Zëvendësdrejtor në drejtoritë e përgjithshme, në varësi të ministrive;

Zëvendësdrejtor i grupit të parë të drejtorive (departamenteve), në varësi të Presidencës, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave.”.

- Në klasifikimin “B5” bëhen këto ndryshime:

Emërtimi “Sekretar i këshillit të rrethit”, zëvendësohet me “Sekretar i këshillit të qarkut”.

Shfuqizohen emërtimet e mëposhtme:

“Drejtor i Drejtorisë Teknike në RTV;

Drejtor i Drejtorisë Ekonomike në RTV;

Zëvendësdrejtor i Radios së Jashtme;

Zëvendësdrejtor i Radios së Brendshme;

Zëvendësdrejtor i Televizionit;

President i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekut;

Zëdhënës i Gjykatës së Lartë;

Drejtor Drejtorie në Komitetin e Zhvillimit të Turizmit.”.

- Në klasifikimin “C2” shtohen emërtimet:

“Specialist në Gjykatën e Lartë;

Sekretar i Kryetarit të Gjykatës së Lartë.”.

- Në klasifikimin “C3” shtohet emërtimi “Sekretar i Kancelarit të Gjykatës së Lartë”.

Në lidhjen II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qëndrore”, shfuqizohen emërtimet e mëposhtme:

“Kancelar në Gjykatën e Lartë;

Drejtor i Përgjithshëm i RTV-së;

Këshilltar juridik në Gjykatën e Lartë;

Drejtor i Drejtorisë teknike në RTV;

Drejtor i Drejtorisë ekonomike në RTV;

President i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekut;

Zëdhënës, referent ligjshmërie në Gjykatën e Lartë;

Kreu “Emërtime të tjera në Gjykatën e Lartë”;

Sekretar i Këshillit Kombtëar të Urdhrit të Mjekut.”.

II. Në vendimin nr. 328, datë 26.6.1995 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin ekonomiko-financiar të efektivit të njësisë së transportit mjekësor me helikopter”, në pikën 1 pagat bëhen si më poshtë vijon:

Përgjegjës i njësisë së transportit mjekësor me helikopter23 760 lekë

Pilot helikopteri19 000 lekë
Teknik helikopteri16 660 lekë
Mjek16 660 lekë
Infermier i ndihmës së shpejtë të njësisë së transportit
me helikopter11 760 lekë.

III. Në vendimin nr. 406, datë 19.6.1995 të Këshillit të Ministrave "Për forcimin e rrjetit hidrometeorologjik dhe sizmologjik", në pikën 2, paga për vrojtuesit bëhet 2 820-3 530 lekë në muaj.

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
**Pandeli Majko**

## LIDHJA NR.2
## KLASIFIKIMI I PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRATËS SË LARTË SHTETËRORE, INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE FUNKSIONARËVE NË PUSHTETIN LOKAL

| | |
|---|---|
| A1 | |
| A2 | |
| A3 | |
| A4 | 112 900 |
| A5 | 105 800 |
| A6 | 98 700 |
| A7 | 91 700 |
| A8 | 84 600 |
| A9 | 77 600 |
| A10 | 75 000 |
| A11 | 73 400 |
| A12 | 71 900 |
| B1 | 66 300 |
| B2 | 63 500 |
| B3 | 53 600 |
| B4 | 43 750 |
| B5,C1 | 36 700 |
| C2 | 32 450 |
| C3 | 28 200 |

## LIDHJA II
## PAGA BAZË SIPAS KLASAVE

| Nr. | KLASA | PAGA |
|---|---|---|
| 1. | I | 9 400 |
| 2. | II | 9 400 |
| 3. | III | 9 700 |
| 4. | IV | 9 700 |
| 5. | V | 10 000 |
| 6. | VI | 10 300 |
| 7. | VII | 10 600 |
| 8. | VIII | 11 000 |
| 9. | IX | 11 500 |
| 10. | X | 12 200 |
| 11. | XI | 12 500 |
| 12. | XII | 14 000 |
| 13. | XIII | 16 700 |
| 14. | XIV | 19 900 |

Shënim: Klasa e parë dhe e dytë njehsohen në pagë dhe klasa e tretë dhe e katërt njehsohen në pagë.

LIDHJA II/1
PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E SHËNDETËSISË

| Nr. | KLASA | PAGA |
|---|---|---|
| 1. | I | 9400 |
| 2. | II | 9400 |
| 3. | III | 9700 |
| 4. | IV | 9700 |
| 5. | V | 10200 |
| 6. | VI | 10500 |
| 7. | VII | 10900 |
| 8. | VIII | 11500 |
| 9. | IX | 12000 |
| 10. | X | 12300 |
| 11. | XI | 12800 |
| 12. | XII | 14600 |
| 13. | XIII | 17400 |
| 14. | XIV | 20800 |

Shënim: Klasa e parë dhe e dytë njehsohen në pagë dhe klasa e tretë dhe e katërt njehsohen në pagë.

LIDHJA II/M
PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E MINISTRIVE, INSTITUCIONEVE TË TJERA QENDRORE, ATSH, PREFEKTURAVE DHE SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR

| Nr. | Klasa | Paga bazë mujore në lekë |
|---|---|---|
| 1. | I | 9 400 |
| 2. | II | 9 900 |
| 3. | III | 10 300 |
| 4. | IV | 11 000 |
| 5. | V | 12 000 |
| 6. | VI | 12 850 |
| 7. | VII | 14 500 |
| 8. | VIII | 17 200 |
| 9. | IX | 18 400 |
| 10. | X | 22 650 |

LIDHJA NR. II-29
NIVELI I PAGËS PËR PUNONJËSIT E GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE, MUZEUT HISTORIK KOMBËTAR, MUZEUT TË ARTIT MESJETAR KORÇË, MUZEU ONUFRI BERAT DHE MUZEUT GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU KRUJË

| Nr. | EMËRTIMI | KLASIFIKIMI |
|---|---|---|
| 1. | Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar<br>Drejtor i Galerisë Kombëtare të Arteve | B3 |
| 2. | Drejtor i Muzeut Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Krujë<br>Drejtor i Muzeut Onufri, Berat<br>Drejtor i Muzeut të Artit Mesjetar, Korçë | B4 |

| Nr. | EMËRTIMI I PUNONJËSIT | Niveli i pagës |
|---|---|---|

| | | Klasa | Shtesa për Funksion (grupi) |
|---|---|---|---|
| 1. | Përgjegjës sektori | VIII | 2 |
| 2. | Lektor | VI | |
| 3. | Kryetar dege | V | 2 |
| 4. | Specialist (inxhinier, arkeolog, restaurator, etj). historian, shpjegues | V | |
| 5. | Llogaritar i parë. Ekonomist | VI | |
| 6. | Piktor.Skulptor | V | |
| 7. | Restaurator | VI | |
| 8. | Ndihmësrestaurator | V | |
| 9. | Vëzhgues salle. Ruajtës fondesh. Fototekist | III | |
| 10. | Punëtor restaurimesh | II-IV | |
| 11. | Biletashitës. Pastrues. Portier. Korier. | I | |

LIDHJA NR. II-30
NIVELI I PAGËS PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS TË INSPEKTORATIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

| Nr. | EMËRTIMI I PUNONJËSIT | Niveli i pagës Klasa | Shtesa për funksion (grupi) |
|---|---|---|---|
| 1. | Përgjegjës zyre | IX | 5 |
| 2. | Teknik. Sekretar | VI | |
| 3. | Shofer i titullarit | V | |
| 4. | Shofer | IV | |
| 5. | Postier | I | |

LIDHJA NR.II-31
NIVELI I PAGËS PËR PUNONJËSIT E GJYKATËS SË LARTË

| Nr. | EMËRTIMI | KLASIFIKIMI |
|---|---|---|
| 1. | Kancelar | A7 |
| 2. | Këshilltar i Kryetarit | A11 |
| 3. | Përgjegjës sektori | B4 |
| 4. | Sekretar i Kryetarit. Specialist | C2 |
| 5. | Sekretar i Kancelarit | C3 |

| Nr. | EMËRTIMI I PUNONJËSIT | Niveli i pagës Klasa |
|---|---|---|
| 1. | Punonjës i ruajtjes së rendit | V-VII |
| 2. | Teknik mirëmbajtje. Operator. Magazinier | VII |
| 3. | Shofer | V |
| 4. | Punëtor pastrimi | III |

**V E N D I M**
**Nr. 298, datë 27.6.2002**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS TË PUNONJËSVE MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat në caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto ndryshime:

1. Lidhja nr.1 "Struktura e pagës për punonjësit mësimorë", lidhja nr.2 dhe lidhja nr.3, "Shpërblimi mujor për punonjësit mësimorë në arsimin parauniversitar, që punojnë larg vendbanimit" zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2002 për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
**Pandeli Majko**

LIDHJA NR.1

| Emërtimi | Paga mujore | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Paga individuale | | | Shtesa e profesionit | |
| | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Totali |
| Drejtor i shkollës së mesme<br>Përgjegjës poligoni<br>Dr.Inst.Nxën.që nuk shikojnë<br>Dr.Inst.Nxën.që nuk dëgjojnë<br>Dr.në shkolla me PLM<br>Drejtor i konvikteve | 1 | 2% e PG për çdo vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 13 350 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |
| Zv/Dr në shkollë të mesme<br>Zv/Dr.në inst.e nx. që nuk shikojnë e dëgjojnë dhe shkollat me PLM<br>Dr.i Qendrës Kult. të fëmijëve<br>Përgjegjës i bazës prodhuese | 1 | 2% e PG për çdo vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 11 130 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |
| Dr.i shkollës 8-vjeçare | 1 | 2% e PG për çdo vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 10 800 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |
| Dr.i shkollës fillore (klasa I-IV)<br>Përgjegjës (kryemësuesi)i shk.me klasë kolektive<br>Zv/Dr.i shkollës 8-vjeçare<br>Përgjegjës sektori në Qendr.Kult.të fëmijëve | 1 | 2% e PG për çdo vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 9 350 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |
| Dr.i kopshtit me ushqim | 1 | 2% e PG për çdo vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 8 000 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |
| Dr.i kopshtit pa ushqim | 1 | 2% e PG për çdo vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 6 600 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |
| Mësues në shkollat e mesme<br>Mësues në Inst.e nx.që nuk shikojnë e nuk dëgjojnë dhe në shkollat me PLM | 1 | 2% e PG për çdo vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 9 450 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |
| Mësues në shkollat 8-vjeçare (I-VIII)<br>Edukator konvikti<br>Kujdestar konvikti<br>Instruktor Qendr.Kulturore të Fëmijëve | 1 | 2% e PG për çdo vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 7 600 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |
| Edukator në kopësht fëmijësh | 1 | 2% e PG | 5% e PG | 5 600 | Nga …..Lekë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | për çdo<br>vit pune | 10% e PG<br>20% e PG | | Deri…...Lekë |
| Mësues | 2 | 2% e PG<br>për çdo<br>vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 7 300 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |
| Mësues | 3 | 2% e PG<br>për çdo<br>vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 7 300 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |
| Edukator në kopësht fëmijësh | 3 | 2% e PG<br>për çdo<br>vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 6 030 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |
| Edukator në kopësht fëmijësh | 2 | 2% e PG<br>për çdo<br>vit pune | 5% e PG<br>10% e PG<br>20% e PG | 6 030 | Nga …..Lekë<br>Deri…...Lekë |

LIDHJA NR.2

| Grupi | Paga në lekë |
|---|---|
| 1 | 8 100 |
| 2 | 6 415 |
| 3 | 5 800 |
| 4 | 3 850 |

LIDHJA NR.3
SHPËRBLIMI MUJOR PËR PUNONJËSIT MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR QË PUNOJNË LARG VENDBANIMIT

Mësuesit që punojnë larg vendbanimit të tyre marrin shpërblim si vijon:

- Kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, deri në 1 200 (njëmijë e dyqind) lekë, kur nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre deri në 3 500 (tre mijë e peseqind) lekë.
- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë deri në 4700 (katër mijë e shtatëqind) lekë kur punojnë në qytet dhe në qendër të rrethit dhe deri në 5800 (pesë mijë e tetëqind) lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.
- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrehtet Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd, deri në 3500 (tre mijë e pesëqind) lekë kur punojnë në qytet dhe në qendër, dhe deri 4700 (katër mijë e shtatëqind) lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.
- Kur punojnë jashtë rrethit të tyre të vendbanimit në rrethet e tjera deri në 2 400 (dymijë e katërqind) lekë kur punojnë në qytet dhe në qendrën e rrethit dhe deri 3500 (tremijë e pesëqind) lekë kur punojnë jashtë qytetit dhe qendrës së rrethit.

**V E N D I M**
**Nr. 299, datë 27.6.2002**

**PËR RRITJEN E PAGAVE TË GJYQTARËVE DHE TË PROKURORËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.7800 datë 2.3.1994 "Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë dhe prokurorëve", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pagat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve rriten në masën 12 për qind sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e

miratuara për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002.

3. Vendimi nr.425, datë 11.6.2001 i Këshillit të Ministrave "Për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
**Pandeli Majko**

## PASQYRA NR.1
## PAGA MUJORE E PUNONJËSVE TË PROKURORIVE

| | |
|---|---|
| Në prokuroritë e apelit | |
| 1. Prokuror apeli | 83 400 lekë |
| 2. Zëvendësprokuror apeli | 69 950 lekë |
| 3. Prokuror | 65 850 lekë |
| | |
| Në Prokurorinë e Rrethit Tiranë | |
| 1. Prokuror rrethi | 65 850 lekë |
| 2. Zëvendësprokuror rrethi | 58 180 lekë |
| 3. Prokuror | 53 790 lekë |
| | |
| Në prokuroritë e rretheve | |
| 1. Prokuror rrethi | 58 180 lekë |
| 2. Zëvendësprokuror rrethi | 53 790 lekë |
| 3. Prokuror | 50 490 lekë |

## PASQYRA NR.2
## PAGA MUJORE E GJYQTARËVE

| | |
|---|---|
| Në gjykatën e apelit civil dhe në gjykatën ushtarake të apelit | |
| 1. Kryetar | 83 400 lekë |
| 2. Zëvendëskryetar | 69 950 lekë |
| 3. Gjyqtar | 65 850 lekë |
| | |
| Në gjykatën e Rrethit Tiranë | |
| 1. Kryetar | 65 850 lekë |
| 2. Zëvendëskryetar | 58 180 lekë |
| 3. Gjyqtar | 53 790 |
| | |
| Në gjykatat e rretheve | |
| 1. Kryetar | 58 180 lekë |
| 2. Zëvendëskryetar | 53 790 lekë |
| 3. Gjyqtar | 50 490 lekë |

## PASQYRA NR.3
## PAGAT E INSPEKTORATIT PRANË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

3.1. Kryeinspektorë dhe inspektorë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë
1. Kryeinspektor 83 400 lekë
2. Zëvendëskryeinspektor69 950 lekë
3. Inspektor65 850 lekë

**V E N D I M**
**Nr. 300, datë 27.6.2002**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.437, DATË 3.9.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË TATIMEVE", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.437, datë 3.9.1993 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
Këshilltar i plotfuqishëm, i ngarkuar për bashkërendimin
ndërmjet organeve të policisë tatimore dhe doganore71900 lekë

b) Në pikën 2, paga mujore për funksionin e Zëvendësdrejtorit
të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve bëhet 53 600 lekë

c) Në pikën 3, niveli më i ulët i pagës bëhet 9 880 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (kryetar dege, drejtor drejtorie) bëhet 26 100 lekë në muaj.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
**Pandeli Majko**

**V E N D I M**
**Nr. 305, datë 27.6.2002**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INSTAT-IT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet "specialist", "përgjegjës sektori", "drejtor drejtorie" dhe "drejtor i përgjithshëm" në Drejtorinë Qendrore të INSTAT-it caktohen sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes 1 - diplomë e shkollës së lartë, është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

6. Në lidhjen II-4/1 të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", me ndryshimet përkatëse, emërtesa "Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT-it" shfuqizohet.

7. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2002 për INSTAT-in.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

KRYEMINISTRI
**Pandeli Majko**

LIDHJA NR. 1

| Emërtimi | Paga mujore | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Paga individuale | | | Shtesa e pozicionit |
| | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) lekë |
| | 1 | 2 | 3 | 4 |
| Drejtor i Përgjithshëm | 9 000 | 2% | 0 | 90 000 |
| Drejtor Drejtorie | 9 000 | 2% | 0 | 74 000 |
| Përgjegjës sektori | 9 000 | 2% | 0 | 40 000 |
| Specialist | 9 000 | 2% | 0 | 20 000 |

## V E N DI M
## Nr. 306, datë 27.6.2002

## PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË NË SISTEMIN MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 dhe 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5. 1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë caktohen sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes 1 - diplomë e shkollës së lartë - është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

6. Shtesa për kushte pune është sipas kolonës 5 të lidhjes nr.1.

7. Mjekët që punojnë larg vendbanimit marrin shpërblim mujor në masën si më poshtë vijon:

a) kur punojnë në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë 4 500 lekë në muaj;

b) kur punojnë në rrethet Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd 3 800 lekë në muaj.

8. Mjekët, të cilët kryejnë specializimin në qendrat spitalore universitare, gjatë kohës së specializimit, të paguhen në masën 80 për qind të pagës së mjekut të fushës në të cilën kryhet specializimi.

9. Për kryerjen e shërbimit të rojes, të gatishmërisë dhe urgjencës, mjekëve u jepet shpërblim si më poshtë vijon:

a) Për çdo shërbim rojë 24 orë pa ndërprerje u jepet një shpërblim:

Në qendrat spitalore uiversitare

| | Mjek rojë i parë | Mjek rojë i dytë |
|---|---|---|
| - për ditët e zakonshme | 1 800 lekë | 1 600 lekë |
| - për ditët e shtuna | 2 200 lekë | 2 000 lekë |
| - për ditët e diela e festat | 2 700 lekë | 2 500 lekë |

NË INSTITUCIONET E TJERA

| | Mjek rojë i parë | Mjek rojë i dytë |
|---|---|---|
| - për ditët e zakonshme | 1 600 lekë | 1 500 lekë |
